

EPPC Albania kërkon një **Retail Supervisor** për klientin e saj, **një ndër optikat më të njohura dhe prestigjioze në vend.**

Përgjegjësitë Kryesore:

1. Mbikqyr hapjen e pikave të reja të shitjes dhe aktivitetin e pikave aktuale;
2. Mirëmban dhe kontrollon ecurinë e punës në aspektin operacional, të shitjeve, anës financiare të pikave të shitjeve etj;
3. Mbikqyr aktivitetet operationale dhe kujdeset për aspektin fitimprurës të rrjetit të dyqaneve duke përbushur objektivat e vendosura nga kompania;
4. Sigurohet për krijimin e një klime të këndshme në dyqan, kupton nevojat e klientëve dhe monitoron kënaqësinë dhe feedback-un e tyre me qëllim ofrimin e një eksperience dhe cilësie shërbimi të lartë;
5. Kujdeset për mirëmbajtjen e standardeve të larta të organizimit dhe ekspozimit të produkteve;
6. Kujdeset për krijimin e një kulture pune në dyqane me qëllim reflektimin dhe ruajtjen e imazhit të BRAND-eve të produkteve në të gjitha veprimtaritë e përditshme;
7. Kujdeset dhe vëzhgon performancën e dyqaneve si dhe përgatit raporte periodike në lidhje me shitjet për drejtuesit e kompanisë;
8. Trajnon, motivon dhe frymëzon stafin me qëllim përbushjen e objektivave dhe rritjen e zhvillimin e performancës së tyre individuale dhe në grup.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare (e preferueshme në Shkencat Ekonomike);
- **Eksperiencë e mëparshme në shitje në pozicione të ngjashme në retail;**
- Të njohë mirë paketën MS Office (*kryesisht Word, Excel*);
- Të ketë leje drejtimi automjeti;
- Aftësi shumë të mira komunikuese, organizuese, problem zgjidhëse dhe të të punuarit nën presion;
- Të jetë person ambicioz dhe të marrë përgjegjësi.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese *deri në datë 31 Maj 2019*, duke ndjekur linkun e mëposhtëm:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.